

BASHKIA VAU DEJËS
NJOFTIM FITUESI

Autoriteti i Dhënies me Qira: Bashkia Vau Dejës njofton se në konkurrimin Publik të zhvilluar me datën 16.08.2024, ora 09:00, publikimi i të cilit është bërë me datën 05.08.2024 në Buletinin e Prokurimeve Publike nr.44, me objekt dhënie me qira:

1. Fillimi i procedurave për dhënie me qira per 10 (dhjetë) vite, me anë të konkurimit publik për sipërfaqen në total 92.34 ha e llojit “ Kullote”, ngastra nr 104 , ekonomia pyjore Pruevos Sheldi, “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogenerator dhe fotovoltai (stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)”, sipas Udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat,

procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”.

Vlera fillestare:

2. Çmimi dysheme i fillimit të konkurrimit është 176.000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë/ha në vit për sipërfaqe të llojit “Kullote” dhe për 92.34 ha është 16.251.840 (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e një mijë e tetëqind e dyzet)lekë në vit për sipërfaqe të llojit “ Kullote”, ndërsa për 0.324 km rrugë x 35 000 lekë/km = 11 340 lekë në vit, pra në total çmimi dysheme është 16.263.180 (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë)lekë e përllogaritur kjo sipas VKM-së nr. 559, datë 29.7.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, dhe sipas Raportit mbi Studimin Tekniko-Ekonomik, përgatitur nga specialistët e fushës.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurën përkatëse të konkurrimit publik këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria “DEJA SOLAR” shpk numri i NIPT-it M43209402V

Oferta e paraqitur për dhënien me qira të sipërfaqes prej 92.34 ha e llojit “ Kullote”, ngastra nr 104 , ekonomia pyjore Pruevos Sheldi, “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltaik(stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)” me afat përdorimi(qiraje) 10 vite është me vlerë prej 16.300.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind mijë)lekë në vit pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

S’ka të skualifikuar

Duke ju referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë:

1. Subjektin “DEJA SOLAR” shpk.

Adresa: Fier, Andon Profka 01490028, Nd.42;H.1; pasura nr.4/112, zk 8534, se oferta e paraqitur, për sipërfaqen prej 92.34 ha e llojit “ Kullote”, ngastra nr 104 , ekonomia pyjore Pruevos Sheldi, “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltaik(stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)”, me afat përdorimi (qiraje) 10 vite, me oferte prej prej 16.300.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind mijë)lekë në vit pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni pranë Bashkisë Vau Dejës, me adresë: Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejës dhe referencë kontakti zyrën e sektorit të Prokurimeve Publike, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, sic parashikohet në dokumentat e konkurimit publik, brenda 10(dhjetë) ditëve nga dita e marjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqen nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siqurimi i ofetës suaj, sic parashikohet në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.09.2024.